




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
Uprava za Poleprivredu, Sumarstvo i Ruralni Razvoj
Department of Agriculture, Forestry and Rural Development
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odelenje za Opštu Upravu

THIRRJE PËR APLIKIM

Nr. I prot. 935 Më 05.10.2018
Br. prot. Dt. 05.10.2018
RAHOVEC - ORAHOVAC

1. Skema e granteve "Përkrahje për përpunues të pemëve dhe perimeve"

Komuna e Rahovecit me lansimin e skemës së granteve për përkrahjen e zhvillimit të ndërmarrësisë do të ndihmojë në plotësimin e nevojave të të berit biznes. Kjo skemë e granteve do të mundësojë që projektet cilësore biznesore të implementohen dhe zhvillohen më tej, duke krijuar kështu vende të reja pune. Këto vende të reja të punës do të gjenerohen nga rritja e ndërmarrjeve ekzistuese që veprojnë në sektorët me potencial më të madhe për zhvillim.

2. Synimet e Thirrjes për Projekt Propozim

Synimi i përgjithshëm i thirrjes është zhvillim socio-ekonomik komunal i balansuar përmes përkrahjes së zhvillimit të bizneseve në sektorin e agroperpunimit në komunën e Rahovecit.

Synimet specifike të kësaj ThPP janë:

- Krijimi i vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për gjininë femërore;
- Zhvillimi i ndërmarrësisë (zejeve) tradicionale të komunës sonë;
- Zhvillimi i ndërmarrësisë që kontribuon direkt në zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

3. Përkrahja financiare e ofruar nga autoriteti kontraktues

Shuma e përgjithshme indikative për këtë thirrje është 30,000. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

Granti do të jepet për:

Projekte të reja biznesi (ndërmarrje "start-up") dhe ekzistuese, që aktivitet primar kanë përpunimin e pemëve dhe perimeve.

4. Shuma e grantit

Grantet do të shpërndahen në dy LOTE:

- Lot. 1: Projektet me vlerë 1,000€ deri 2,500€
- Lot. 2: Projektet me vlerë 2,500€ deri 5,000€

Përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët duhet të jetë 20%. Shuma prej 80% mbulohet nga Autoriteti Kontraktues. Vlera maksimale e përkrahjes është 80% e vlerës për Lote.

5. Kualifikimi i aplikanteve: kush mund të aplikojë?

Për t'u kualifikuar për grant, aplikanti/ja duhet:

- Të jenë shtetas të Kosovës, banor rezident i komunës së Rahovecit (dëshmohet me kopjet e letërnjoftimit),
- Aplikanti i përzgjedhur duhet që ligjërisht të themelojë biznesin në komunën e Rahovecit para nënshkrimit të Kontratës së Grantit,
- Të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit,
- Bizneset e regjistruara duhet që të kanë të shlyera të gjitha obligimet ndaj Komunës së Rahovecit,
- Personat Fizik që aplikojnë të kenë të shlyera obligimet ndaj tatimit në pronë.

6. Aplikantët që nuk kualifikohen

Aplikantët potenciale nuk mund të marrin pjesë në ThPP janë të renditur si në vijim:

- Është shërbyes civil në ndonjë nga institucionet lokale ose qendrore të Kosovës,
- Është banor nga ndonjë komunë tjetër,
- Kanë bankrotuar apo janë në mbyllje, janë nën administrim të gjykatave,
- Kanë pezulluar aktivitetet afariste,

7. Sektorët

Përmes thirrjes aplikantët duhet të paraqesin **projekt-propozim** për sektorët:

- Përpunim i perimeve dhe
- Përpunim i pemëve

8. Lokacioni

Projekti duhet të realizohet në territorin e komunës së Rahovecit.

9. Formularët e aplikimit

Aplikantët duhet të dorëzojnë formularin e aplikimit duke përdorur formularin e aplikimit të ofruar nga autoriteti kontraktues të bashkangjitur në këtë udhëzim .

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

Nëse aplikuesi është person fizik:

- Formulari i aplikimit
- ID e aplikuesit,
- Projekt Propozimi,

- Vërtetimi i tatimit në pronë,
- Konfirmimi për llogari bankare.

Nëse aplikuesi është person juridik:

- Formulari i aplikimit,
- Projekt Propozimi,
- Certifikata e biznesit (informata për biznesin) dhe
- Certifikata e numrit fiskal,
- ID e pronarit,
- Vërtetim që i ka të shlyera obligimet ndaj Komunës së Rahovecit.

10. Kriteret specifike të përzgjedhjes për LOT 2.

- Të jetë biznes i regjistruar (aktiv në ARBK),
- Të ketë të deklaruar së paku 3 punëtor brenda vitit 2018 (dëshmi e ATK-së)
- Të ketë eksport gjatë vitit 2018 (të dëshmohet me DUD)

Vlerësimi i aplikacioneve do të përfshijë kontrollin administrativ, kontrollin e kualifikueshmëris dhe vlerësimin final. Procesi i kontrollit teknik do të vlerësojë nëse aplikuesi ka paraqitur dokumentet e kërkuara me këtë udhëzues, kontrolli i kualifikueshmëris do të vlerësojë nëse aplikuesi ka respektuar kriteret e kualifikueshmëris dhe vlerësimi final i cili do të vlerësojë në bazë të kriterëve për vlerësim. Granti do ti jepet aplikanteve (me notë më të lartë), deri në kufijtë e buxhetit në dispozicion.

11. Shpenzimet e pranueshme

Llojet vijuese të aktiviteteve në përputhje me synimet e THPP llogariten si **shpenzime të kualifikueshme**:

- Investimet në asete të prekshme që kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve, makinerisë, linjat e prodhimit, përmirësimin e proceseve dhe metodave prodhuese;

12. Mënyra e Aplikimit

Aplikacioni mund të shkarkohet në WEB-faqe të Komunës së Rahovecit, ose të tërhiqet në zyrat e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Aplikacioni i plotësuar duhet dorëzuar në adresën:

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Rahovecit
Rr. Xhelal Hajda pn.

13. Afati për dorëzimin e aplikacionit të plotë.

Afati për dorëzimin e aplikacionit është nga 07 tetor 2018 deri më 17 tetor 2018, në ora 16:00.